



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 37, date 24/05/2002

PER
NJE DETAJIM NE PLANIN E INVESTIMEVE NGA TE ARDHURAT
PER VITIN 2002, NE ZERIN "PROJEKTIME E SUPERVIZIME"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore", neni 19/9 dhe neni 32, gërma dh, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993, "Për buxhetin lokal", neni 5, ndryshuar me ligjin Nr.8399 dt.22.12.1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993" V.K.M. Nr.444 dt.05.09.1994 "Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 "Për miratimin e buxhetit për Bashkinë e Tiranës për vitin 2002" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.30 dt.19.04.2002 pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, mbi realizimin e projekteve të disa rrugëve të cilat janë përfshirë në programin e prioritetive të investimeve publike në qytet, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Ligjit Nr.7582 dt.13.07.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", neni 3, ndryshuar me ligjin Nr.7670, dt.09.02.1993 dhe Nr.7743 dt.26.07.1993 "Për ndërmarrjet shtetërore", V.K.M. Nr.349 dt.23.05.1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.130 dt.28.04.1994, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.20 dt.13.02.2001 dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.62 dt.10.07.2001 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të detajojë fondin prej 7.721.000 lekësh nga fondi prej 11.000.000 lekë, nga plani i investimeve nga të ardhurat për vitin 2002, zëri “Projektim e Supervizim për infrastrukturën e rëndë”, si fond projektimi për realizimin e projekteve të infrastrukturës së rëndë, për objektet si më poshtë:
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Vaso Pasha”
Fondi i projektimit 1.517.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Mine Peza”
Fondi i projektimit 655.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Zhan D’Ark”, segmenti nga ura e Rrugës “Vasil Shanto” në urën e Rrugës “Irfan Tomini”
Fondi i projektimit 1.500.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Margarita Tutulani”
Fondi i projektimit 864.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Gjike Kuqali”
Fondi i projektimit 850.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Siri Kodra”
Fondi i projektimit 1.860.000 lekë
 - Projekti për rikonstruksionin e Rrugës “Lekë Dukagjini”
Fondi i projektimit 475.000 lekë
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria e Prokurimeve për zbatimin e këtij Vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Leonidha TOSKA

